REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 345/19
Datë/Datum. 27-06-2019
PRISHTINË - PRISTINA

Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave – FO2, "AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Anulimi datës 13/06/2019 dhe Letër Standarde për për Tenderuesin e Eliminuar e datës 13/06/2019 si dhe përgjigje në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 17/06/2019 paraqet:

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër Kuvendi i Komunës së Prishtinës, 10000 Prishtinë Republika e Kosovës;

Për Aktivitetin e Prokurimit: **616 - 19- 2765 -1-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 615 – 19 – 079 –121**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me dru**

## ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit*** *"AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë*

*Komuna e Prishtinës* — *10000*
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*
*049 84 04 93*

*aomeshp-ks@outlook.com* — *znj. Nafije Makolli*
*(Adresa elektronike)*

*25/06/2019*
*(Data e parashtrimit të ankesës)* — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara "AOME" Sh.p.k. Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

*Njoftimi për Kontratë i publikuar në web faqen e platëformës elektronike të KRPP-së dt.02/05/2019;*

*Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 23/05/2019 ora 14:00, Komuna e Prishtinës zyra e prokurimit 10000 Prishtinë Republika e Kosovës;*

*Hapja e ofertave nga përbërja e komisionit të AK-së në prezencën e ofertuesve është bërë më datë 23/05/2019 ora 14:00, Zyra e Prokurimit,*

*Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Vendim për anulimin e procedurës së prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 13/06/2019;*

*Letër standarde për tenderuesine eliminuar e datës 13/06/2019*

*Kriteri për dhënien e Kontratës:* ***Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;***

*Paraqitja e mjeteve juridike: Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues e datës 14/06/2019*

*Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim e datës 17/06/2019*

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [x] Jo [ ]

Është organizuar procesi i hapjes publike të ofertave. Asnjëri nga Operatorët Ekonomik të pranishëm në procesin e hapjes publike të ofertave nuk ka pasur vërejtje.

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të dokumenteve të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: '***Furnizim me me dru*** me numër të e prokurimit: 616 - 19- 2765 -1-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 615 – 19 – 079 –121 –221 Ne në cilësinë e Operatorit Ekonomik të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 13/06/2019 nga Autoriteti Kontraktues është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet nënligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë e ka dëmtuar rendë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga AK të cilat janë konstatuar nga "AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë

Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi,shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim / jo – Diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

Është shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i Tenderëve).

Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

Është shkelur neni 62 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

Është shkelur neni 44 i RRUOPP-së (Ndërprerja e procedurave të prokurimit).

- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*
Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
Paragrafi I pare I këtij neni thotë:

1. "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

- Është shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i Tenderëve).

Me datë 13/06/2019 përmes Letër standarde për tenderuesin e eliminuar na njoftoni se jemi eliminuar me disa arsyetime të paqendrueshme. Në arsyetim shkrueni se "keni *dhënë çmimin më të lartë se sa çmimet mesatare të dhena për disa artikuj dhe shërbime reprezentuese, prill2019 ku në kodin 418 – dru zjarri, çmimi referent është 35.27, ndërsa ofertat e pranuara kanë çmime dukshë më të larta"*

Pas dorëzimit, përkatësisht dërgimit pëmes postes elektronike të Kërkesës për Rishqyrtim më datë 01/04/2019 ju na ktheni një përgjigje mennjëherë fare pa e trajtuar gjoja se Kërkesa për Rishqyrtim është dërguar pas kalimit të afatit për dorëzim dhe shkrueni në njoftim:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Neni 44 i RRUOPP Ndërprerja e procedurave të prokurimit

44.1 Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do te publikoj Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.
44.2 Pas skadimit te afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim te ankesave, do të përgatite Njoftimin për Anulim te aktivitetit te prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tille do ta publikojë ne platformën e prokurimit elektronik.
44.3 Dorëzimi i njoftimin të anulimit të tillë në KRPP dhe publikimi i njoftimit të tillë nuk është i nevojshëm për kontratat me vlerë minimale.
44.4 Njoftimi për anulim për kontratat me vlerë të vogël dhe të mesme do të përgatitet në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërsa për kontratat me vlerë të madhe në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
44.5 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
(i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

(iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
(iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
(vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
(x) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit nga KRPP; ose

(xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

44.7 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:

(i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;
(ii) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit nga KRPP;

(iii) është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP;

(iv) nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit te platformes elektronike nga te gjithë përdoruesit si pasoje e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit te KRPP-se dhe AK.

.
44.8 Në rast të anulimit bazuar në rrethana dhe arsye të deklaruara në këtë nen, autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tenderuesve, pjesëmarrësve ose kandidatëve për anulim të një procedure të prokurimit, subjekt i dispozitave të Nenit 105, paragrafi 2.9 të LPP në lidhje me kompensimin e ankuesit.
44.9 Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tender".

**Në asnjërin nga pragrafet e nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 dhe të nent 44 të RRUORP (Ndërprerja e procedurave të prokurimit) nuk parashihet ajo që ju e këni shkruar në arsyetimin e dhënë në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar dhe në vendimin e juaj për anulim të këtij aktivitetit të prokurimit.**

Përgjigjën e autoritetit kontraktues, përkatësht nga zyra e prokurimit e kemi pranuar që ka të bëjë me Kërkesën tonë për Rishqyrtim të dërguar më datë 14/06/2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru", me numër të prokurimit: Për Aktivitetin e Prokurimit: 616 - 19- 2765 -1-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 615 – 19 – 079 –121

Përgjigja e juaj nuk është e mbeshtetur në asnjë nen të - Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, dhe në RRUOP

Pra arsyetimi i juaj është i paqendrueshem dhe pa argumentuar edhe pse ju thirreni në Agjencionin e Statistikave të Kosovës çmimetë cilat i paraqet apo deklaron Agjencioni i

Statistikave të Kosovës janë çmime në të cilat nuk është llogaritur dhe kalkuluar TVSH-ja. Nëse çmimit të cilin ju e keni shënuar në areyetimin tuaj i shtohet 18% sa është norma e TVSH-së 35.27 x 18% vetëm TVSH-ja është 6.35 dhe 35.27+6.35=41.62 euro dhe kur t' i shtohen shpenzimet tjera si ngarkimi, zhgarkimi palimi dhe sharrimi i tyre e tjkalojnë çmimin të cilin në e kemi vënë në ofertën tonë e që është një çmim mjaft i arsyeshëm.

Si duket autoritetit kontraktues –zyrës së prokurimit nuk iu ka "shkrepur" oferta e operatorit ekonomik të preferuar që të jetë me çmim më të ulët dhe çka të bëjmë të anulojmë aktivitetin e prokurimit e ndoshta herën tjetër "shkrepë". Dihet se edhe anulimi i aktivitetit të prokurimit duhet të mbeshtetet në LPP dhe në aktet nënligjore.

Po e theksoj edhe këte së autoriteti i juaj kontraktues kontraten e vitit të kaluar e ka pasur të nënshkruar dhe ralizuar me një Operator ekonomik me çmim prej 48 m kub

Andaj duke konsideruar se me vendimet e ankimuara AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore të lartshënuara të LPP-së dhe akteve tjera nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e Operatorit Ekonomik "AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP-ja, përkatësisht Paneli Shqyrtues që në një sencë kryesore të hapur, ku do të jetë i pranishëm edhe përfaqsuesi i jonë i autorizuar, pas trajtimit të lëndës dhe shkeljeve të konstatuara të këhtei landën në ri-vlerësim pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve përkatësisht parregullësive të paraqitura në ankesë - dhe pas veprimeve korrigjuese, i propozojmë të merr këtë:

V E N D I M

- MIRATOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë

- ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platësormes elektronike të KRPP-së me datë 13/06/2019

- ANULOHET Vendimi – Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e datës 13/06/2019 ""AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e opratorit ekonomik "AOME"SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës si ofertë e përgjegjshme me çmim me të ulët.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

| |
|---|
| Dëmet materjale janë të konsiderueshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e dosjes së tenderit:<br><br>Përgatitja e Kërkeses për Rishqyrtim,<br><br>Përgatitja e kësaj ankese,<br><br>Dëmet më të mëdha do t'i shkatohen Operatorit Ekonomik "AOME" SH.P.K ; Ndërmarja Tregtare Shërbyese "TINI" Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë nëse nuk do të vlerësohet ofertë e përgjegjshme për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit.<br><br>Të gjitha dëmet materiale do të konstatohen në të ardhmën nga ekspërtet ligjore përkatës gjatë zhvillimit të procedurës në të ardhmën. |

## . Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *një kopje të publikimit për Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Anulimi datës 13/06/2019 ;*
c) *një kopje të letrës standarde për ofertuesin e eliminuar*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
e) *e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
f) *Kopje e Kërkesës për Rishqyrtim të dërguar pranë Autoritit Kontraktues me datë 14/06/2019*
g) *Vendim - Përgjigje në Kërkesë për Rishqyrtim të Autoritit Kontraktues e datës 17/06/2019*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*